


# VENDI PREJ NGA

## KUVENDI I KOSOVË'S



# DALIN LIGJET

## DEMOKRACIA, PJESË E JETËS SONË

ALAUDIN (11), BLERON (11), MEDINA (11), RUMESA (12), ELTONI (11), ELIJES (12), GENARD (11)



**Ne tani jemi të vetëdijshëm për të mirat që na i mundëson kjo formë e qeverisjes, pra demokracia. Ne gjithashtu do të punojmë për të mirën e shtetit tonë**

Demokracia është gjëja më e rëndësishme e një shteti dhe një populli. Ajo përfshin të drejtat e njeriut, me një fjalë ajo i përfshin të gjithë qytetarët. Kjo formë e qeverisjes rrjedh nga fjala greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje apo udhëheqje. Në kohët e lashta nuk ka pasur barazi gjinore apo barazi në bazë të nivelit ekonomik, sepse atëherë vetëm të pasurit kanë pasur të drejta. Por, tani të gjithë trajtoheni në mënyrë barabartë dhe pa asnjë dallim. Demokracia lindi shumë vite më parë, më saktësisht në vitin 507 para erës sonë në Athinë të Greqisë. Atëherë demokracia nuk ka qenë njësoj si sot, sepse të drejtë vote kishin vetëm të pasurit, kurse të varfërit kanë qenë të shtypur. Demokracia ndahet në disa forma, por më të përhapura janë demokracia e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese.

Në Kosovë kemi demokraci përfaqësuese, ku të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare me anë të drejtës së votës, zgjedhim deputetët tanë, të cilët na përfaqësojnë në Kuvendin e Kosovës.

Demokracia përfshin shumë elemente si toleranca, respekti ndaj tjetrit, barazia, liria, respektimi i të drejtave të njeriut etj. Nga kjo nxjerrim se demokracia me kohë është zhvilluar dhe ne sot gëzojmë shumë të drejta dhe konsiderohemi të barabartë me njëri-tjetrin.



Autorët e artikullit




Kemi rezultate të mira vetëm kur bashkëpunojmë



Një ndër elementet bazë të demokracisë




Përkushtimi ynë drejt suksesit



Shkollimi është e drejtë e secilit



Bashkëpunimi na ndihmon në realizimin e ëndërrave tona



Detyrat e Kuvendit të Kosovës



Me punë i arrijmë qëllimet tona

# PUSHTETI DEMOKRATIK NË KOSOVË

BLERON (11), FLORENT (11), ZEQIR (11), ENDRIT (11), VLERA (11), DIART (11), BLERTA (11)



## Ne mendojmë që ndarja e pushtetit në një vend demokratik është shumë e nevojshme

Sot mësuam për demokracinë dhe ndarjen e pushtetit. Demokracia përfshin lirinë e fjalës, lirinë e lëvizjes, të drejtat themelore të njeriut dhe më e rëndësishmja sipas mendimit tonë është zgjedhja e lirë. Kjo mendojmë se është më e rëndësishmja, sepse një popull në një shtet demokratik i zgjedh përfaqësuesit e tyre përmes zgjedhjeve të lira.

Për ndarjen e pushtetit mësuam se ndahet në tri pjesë: Pushteti Legjislativ që është Kuvendi, Pushteti Ekzekutiv që është Qeveria dhe Pushteti Gjyqësor që janë Gjykatat. Pushteti ndahet në mënyrë që secili prej pushteteve t'i ketë detyrat e veta.

Në Kuvend punojnë deputetët e zgjedhur nga populli përmes votave të lira. Pastaj, deputetët e zgjedhin Kryeministrin dhe Presidentin. Por, kjo nuk është detyrë e tyre kryesore, sepse detyrë e kryesore e deputetëve është miratimi i ligjeve të reja.

Funksionet kryesore të Kuvendit janë: funksioni përfaqësues sepse e përfaqëson popullin, funksioni kontrollues sepse e kontrollon Qeverinë dhe funksioni legjislativ sepse siç e cekëm më lart miraton ligjet. Në Qeveri që është Pushteti Ekzekutiv, punojnë Kryeministri dhe ministrat. Njëra prej detyrave të tyre është të propozojnë ligje në Kuvend. Por, detyrë kryesore e tyre është t'i ekzekutojnë ligjet që i miraton Kuvendi. Kjo do të thotë se Qeveria duhet të sigurohet që të ketë zhvillim të mirë ekonomik, arsimor, shëndetësor etj. Shteti ynë sigurohet që ka zhvillim arsimor duke na siguruar neve libra, shkolla, banka, karrige etj. Gjykatat hyjnë në sistemin gjyqësor të Kosovës. Në këtë sistem punojnë gjykatësit, prokurorët, avokatët etj. Ekzistojnë tri lloje të gjykatave, e ato janë: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Ne e dijmë se Republika e Kosovës është shtet demokratik dhe ne do të punojmë që ajo të vazhdojë të mbetet demokratike edhe më tej.



Gazetarët duke punuar për artikull



Autorët e artikullit

# TË DREJTAT E QYTETARËVE NË DEMOKRACI

VALDRIN (11), GETOAR (11), ALBION (12), AULONA (12), ERMIRA (11), ALDIN (11), ARLIND (11)


## Kontributi dhe ndikimi i qytetarëve aktiv në një shtet të caktuar

Ne kur erdhëm në Punëtorinë e Demokracisë bëmë disa aktivitete, pastaj vazhduam të diskutojmë për demokracinë. Nga biseda kuptuam se në demokraci qytetarët aktiv janë shumë të rëndësishëm, sepse ata japin kontributin e tyre për vendin në të cilin jetojnë. Janë tri nivele ku qytetarët aktiv mund të ndikojnë dhe të veprojnë. Sa i përket ndikimit në nivel lokal, si shembull kemi pastrimin e lagjes nga banorët e saj. Në nivel kombëtar qytetarët ndikojnë duke marrë pjesë në procesin zgjedhor. Nivel tjetër është edhe ai ndërkombëtar apo global, ku për të mbrojtur ajrin mund të mbjellim pemë nëpër vende të ndryshme në botë, sepse ato lirojnë oksigjenin i cili ndikon në pastrimin e ajrit.

Të gjithë njerëzit pavarësisht gjinisë, racës, apo fesë, i kanë të drejta të barabarta. Ne të gjithë kemi të drejtën e leximit, të drejtën e shkollimit, të drejtën e familjes, të drejtën e shprehjes së mendimit, të drejtën e lojës etj. Ndërsa, për të votuar në procesin zgjedhor ne duhet t'i mbushim 18 vjet, sepse atëherë do të jemi më të pjekur dhe më të vetëdijshëm për veprimet dhe zgjedhjet tona.

Në demokraci edhe pse populli ka liri, prapë se prapë duhet të ketë tolerancë ndaj njëri-tjetrit. Me tolerancë kuptojmë respekt dhe mirëkuptim.

Ne grupi ynë, shpresojmë që ky artikull do t'iu pëlqejë dhe do të kuptoni rëndësinë e demokracisë dhe qytetarëve aktiv.



Grupi ynë duke bashkëpunuar



Gazetarët e artikullit



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Zenel Hajdini“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë